



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.28, datë 08.03.2023

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT NR.19,
DATË 28.07.2020 “PËR MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“STRUKTURË HOTELERIE (APARTAMENT HOTEL) DHE SHËRBIMI 1 - 5 KATE
MBITOKË DHE 3 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË GJILEKË, BASHKIA
HIMARË”

Në mbështetje të neneve 28, 29 dhe 113, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Rinia – 04” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, të miratuara me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.19, datë 28.07.2020 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Strukturë hotelerie (Apartament Hotel) dhe shërbimi 1 - 5 kate mbitokë dhe 3 kate nëntokë”, me vendndodhje në Gjilekë, Bashkia Himarë, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkangjitur këtij vendimi.
2. Procedurat administrative/ligjore të përmendura në Vendimin e KKT-së Nr.19, datë 28.07.2020 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Strukturë hotelerie dhe shërbimi 1 dhe 5 kate”, me vendndodhje në Gjilekë, Bashkia Himarë, do të vijohen nga Bashkia Himarë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me “Marrëveshjen për Delegimin e Kompetencave” të nënshkruar mes Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Kryetarit të Bashkisë Himarë, në datë 28.07.2020, si dhe ndryshimin e saj, bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR / LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

